



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026
ME ZGJEDHJE - SESIONI I

Skemë vlerësimi

Lënda: Gjeografi

23 qershor 2026

Varianti A

Shënim:

- Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet me zhvillim dhe arsytim, që kanë më shumë se një mundësi zgjidhjeje.
- Çdo zgjidhje e dhënë nga nxënësit ndryshe nga skema e vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, do të marrë pikët përkatëse.
- Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa vlerësohen me 1 pikë.

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	A	C	A	D	C	A	A	C	B	C
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Alternativa e saktë	C	C	B	C	D	B	A	C	D	B

Pyetjet me zhvillim dhe arsytim

Pyetja 21 **3 pikë**

Model përgjigje:

- a) Projektion cilindrik. **1 pikë**
 b) Për zonat pranë ekuatorit, pasi shformohen shumë më pak sesa zonat e tjera në gjerësi më të mëdha gjeografike. **1 pikë**
 c) Groenlanda, Antarktida, etj. **1 pikë**

a) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi emërton saktë projektionin hartografik.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon se për cilat zona të Tokës do të ishte më i përshtatshëm ky lloj projektioni.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

c) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi përmend një territor që, në këtë projektion, paraqitet me përmasa më të mëdha se në realitet.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Në gjerësitë ekuatoriale: Erërat e Pasateve/Alizeve
- Në gjerësitë mesatare: Erërat Perëndimore
- Në gjerësitë polare: Erërat Lindore

- 3 pikë** Nëse nxënësi emërton saktë erërat e qarkullimit të përgjithshëm që formohen në të tri gjerësitë e kërkuara.
- 2 pikë** Nëse nxënësi emërton saktë erërat e qarkullimit të përgjithshëm që formohen në dy prej tri gjerësive të kërkuara.
- 1 pikë** Nëse nxënësi emërton saktë erërat e qarkullimit të përgjithshëm që formohet në një gjerësi të kërkuar.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 23 **2 pikë****Model përgjigje:**

- a) Lartësia e valës rritet nga 0.5 m në 20 m.
- b) Shpejtësia e valës zvogëlohet nga 800 km/orë në 50 km/orë.

a) **1 pikë**

- 1 pikë** Nëse nxënësi përshkruan saktë ndryshimin e lartësisë së valës nga deti i hapur drejt bregut.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

- 1 pikë** Nëse nxënësi përshkruan saktë ndryshimin e shpejtësisë së valës nga deti i hapur drejt bregut.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 24 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Prania e shkëmbinjve të tretshëm (kryesisht gëlqerorë).
- Reshje të bollshme që favorizojnë procesin e tretjes.
- Prania e çarjeve dhe plasaritjeve në shkëmbinj, të cilët lejojnë depërtimin dhe qarkullimin e ujit.
- Pjerrësi e vogël e sipërfaqes, që mundëson veprimin më të gjatë të ujit mbi shkëmbinjte.
- Prania e ujërave të pasura me dioksid karboni, të cilat rrisin aftësinë tretëse të ujit.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi evidenton tri kushte që favorizojnë formimin e relievit karstik.
- 2 pikë** Nëse nxënësi evidenton dy kushte që favorizojnë formimin e relievit karstik.
- 1 pikë** Nëse nxënësi evidenton një kusht që favorizon formimin e relievit karstik.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 25 **3 pikë****Model përgjigje:**

- a) Dy nga çrregullimet që pëson klima e Shqipërisë janë: **2 pikë**
- paqëndrueshmëria e klimës.
 - regjimi shumë i çrregullt i reshjeve.
 - etj.

- b) Shpjegimi: **1 pikë**
- Paqëndrueshmëria e klimës duket në raste kur temperaturat ulen, madje edhe në stinët e ngrohta, duke dëmtuar kulturat bujqësore.
Shirat intensive me shtrirje të madhe gjeografike dhe kombinimi i tyre me shkrirjen e shpejtë të dëborës shkaktojnë vërshime të lumenjve, përmytje të tokave dhe të qendrave të banuara.
 - Regjimi shumë i çrregullt i reshjeve: Reshjet kanë ecuri të kundërt me temperaturën; ato janë përqendruar në stinën vjeshtë-dimër, kur nevojat për to janë minimale, pra në këto stinë krijohet tepricë e madhe lagështire. Gjatë stinës së verës shfaqen thatësira të theksuar që zgjasin 2-3 muaj, prandaj bimët e kultivuara nuk zhvillohen pa ujitje artificiale.

- a) **2 pikë**
2 pikë Nëse nxënësi përcakton dy nga çrregullimet që pëson klima e Shqipërisë.
1 pikë Nëse nxënësi përcakton një çrregullim që pëson klima e Shqipërisë.
0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

- b) **1 pikë**
1 pikë Nëse nxënësi shpjegon një nga këto çrregullime.
0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të degraduara.
- Ndërtimi i brezave mbrojtës dhe terasave në tokat me pjerrësi.
- Përdorimi i teknikave të qëndrueshme të bujqësisë.
- Kufizimi i shfrytëzimit të pakontrolluar të tokës.
- Menaxhimi i kullotave dhe mbrojtja e mbulesës bimore.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi përcakton tri masa që mund të ndihmojnë në menaxhimin efektiv të erozionit të tokës.
2 pikë Nëse nxënësi përcakton dy masa që mund të ndihmojnë në menaxhimin efektiv të erozionit të tokës.
1 pikë Nëse nxënësi përcakton një masë që mund të ndihmojë në menaxhimin efektiv të erozionit të tokës.
0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 27 **3 pikë****Model përgjigje:**

Para viteve 1945:

- ekonomia ishte e prapambetur.
- të ardhurat kryesore siguroheshin nga bujqësia dhe blegtoaria.
- teknikat e përdorura ishin të prapambetura dhe me produktivitet të ulët.
- tokat ishin të ndara në ngastra dhe nuk realizohej plehërimi dhe kullimi i tyre.
- mekanizimi i punimit të tokës mungonte.
- infrastrukturë e pa zhvilluar dhe mungesë e industrisë së rëndë.
- etj.

Në vitet 1945-1990:

- zhvillimi ekonomik u mbështet në planet 5-vjeçare.
- u realizua kolektivizimi i bujqësisë dhe krijimi i kooperativave dhe fermave shtetërore.
- u ndaluan investimet e huaja dhe ndihma nga jashtë, ekonomia e vendit u fokusua vetëm te potencialet e veta.
- iu dha përparësi industrisë së rëndë.
- ndërtimi i infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe hidrocentraleve.
- tharja e kënetave, krijimi i kanaleve kulluese.
- etj.

Pas viteve 1990:

- kalimi në ekonominë e tregut të lirë dhe privatizimi masiv i ndërmarrjeve dhe pronave shtetërore.
- rritja e sektorëve të shërbimeve, ndërtimit, turizmit dhe tregtisë.
- rënia e industrisë shtetërore dhe shkatërrimi i kooperativave bujqësore.
- etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi identifikon nga një tipar dallues të zhvillimit ekonomik për të tri periudhat e kërkuara.
- 2 pikë** Nëse nxënësi identifikon nga një tipar dallues të zhvillimit ekonomik për dy periudha të kërkuara.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon një tipar dallues të zhvillimit ekonomik për një periudhë të kërkuar.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 **4 pikë****Model përgjigje:**

Ndikimet pozitive.

- Mundësi punësimi.
- Përmirësim i infrastrukturës.
- Përmirësim i jetës sociale.
- Rritje e të ardhurave.
- Etj.

Ndikimet negative.

- Prishje e ekuilibrave mjedisorë, ndotje.
- Problem me menaxhimin e mbetjeve.
- Ndërtime pa kriter.
- Diskriminim.
- Etj.

- 4 pikë** Nëse nxënësi evidenton dy nga ndikimet pozitive dhe dy nga ndikimet negative të turizmit.
- 3 pikë** Nëse nxënësi evidenton dy nga ndikimet pozitive dhe një nga ndikimet negative **OSE** një nga ndikimet pozitive dhe dy nga ndikimet negative të turizmit.
- 2 pikë** Nëse nxënësi evidenton dy nga ndikimet pozitive **OSE** dy nga ndikimet negative të turizmit **OSE** një nga ndikimet negative dhe një nga ndikimet pozitive të turizmit.
- 1 pikë** Nëse nxënësi evidenton një nga ndikimet pozitive **OSE** një nga ndikimet negative të turizmit.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Vija bregdetare.
Ka një vijë bregdetare të thyer e të copëtuar. Ajo përfshin pjesën e Ismit dhe atë të arkipelagëve ishullorë; dallohen gadishulli Jukatan dhe arkipelagët e Antileve të Mëdha dhe të Vogla, etj.
- Relievi.
Dallohet për relieve të larta malore me lartësi 4000-5000 metra mbi nivelin e detit; malet kryesore janë Sierra Madre Perëndimore dhe ato Lindore; ultësirat dhe rrafshnaltat zënë sipërfaqe të vogël kryesisht përgjatë bregdetit apo në luginat midis maleve të lartë, etj.
- Klima.
Për shkak të ndryshimit të lartësisë ka dhe ndryshime të elementëve klimatikë; në lartësitë më të ulta dallohet klima e ngrohtë e tipit ekuatorial e musonit, më lart ajo tropikale e butë e deri në lartësitë më të mëdha ajo kontinentale e malore e ftohtë me temperaturë të ulta e me reshje të borës; etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi përcakton nga një tipar dallues të vijës bregdetare, relievit dhe klimës të Rajonit të Amerikës Qendrore.
- 2 pikë** Nëse nxënësi përcakton nga një tipar dallues të dy prej elementëve natyrorë të Rajonit të Amerikës Qendrore.
- 1 pikë** Nëse nxënësi përcakton një tipar dallues të një prej elementëve natyrorë të Rajonit të Amerikës Qendrore.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30 **2 pikë****Model përgjigje:**

- a) Një nga tiparet dalluese të hidrografisë të pjesës kontinentale të rajonit të Azisë Lindore është: **1 pikë**
- dallohet për sisteme hidrografike të gjata me lumenj të mëdhenj me ujë të bollshëm.
 - lumenjtë burojnë nga zonat e larta malore në perëndim dhe rrjedhin drejt lindjes dhe juglindjes.
 - kanë regjim të çrregullt të rrjedhjes, që ndikon negativisht në kohën e përmytjeve.
 - lumenjtë kryesorë janë: Huanhe dhe Jance, Mekong.
 - etj.
- b) Një nga tiparet dalluese të relievit të pjesës ishullore të rajonit të Azisë Lindore është: **1 pikë**
- pjesa ishullore dallohet për reliev malor me drejtim meridional veri-jug nga ishujt Aleutine deri në Filipine.
 - një pjesë e relievve malore janë me origjinë vullkanike, pasi pjesa ishullore përfshihet në "Unazën e Zjarrtë të Paqësorit".
 - etj.
- a) **1 pikë**
- 1 pikë** Nëse nxënësi përcakton një nga tiparet dalluese të hidrografisë të pjesës kontinentale të rajonit të Azisë Lindore.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.
- b) **1 pikë**
- 1 pikë** Nëse nxënësi evidenton një nga tiparet dalluese të relievit të pjesës ishullore të rajonit të Azisë Lindore.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 **3 pikë****Model përgjigje:**

Disa veçori të popullimit të Australisë janë:

- për shkak të kushteve klimatike dhe atyre natyrore Australia është pak e populluar, pra ka numër të ulët të popullsisë.
- ka shpërndarje të pabarabartë të popullsisë, kryesisht përgjatë brigjeve detare, në pjesën lindore, jugperëndimore dhe jugore.
- dallohet për dendësi të vogël të popullsisë.
- shtimi natyror është në nivele të ulëta.
- mbi 80 % e popullsisë janë pasardhës të anglezëve, por nga përbërja e popullsisë është heterogjene, ku jetojnë dhe pakicat etnike.
- dallohet për nivele të larta të imigracionit.
- etj.

3 pikë Nëse nxënësi jep tri nga veçoritë e popullimit të Australisë.

2 pikë Nëse nxënësi jep dy nga veçoritë e popullimit të Australisë.

1 pikë Nëse nxënësi jep një veçori të popullimit të Australisë.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **4 pikë****Model përgjigje:**

- a) Një tipar dallues për secilin nga llojet e lëvizjes migratore janë: **2 pikë**
 Migracion ndërkombëtar: lëvizje nga një vend në një vend tjetër, përtej kufijve, udhëtime jashtë vendit; lëvizja e njerëzve për arsye të ndryshme nga një shtet në një shtet tjetër.
 Migracion i brendshëm: lëvizje nga një pjesë e një vendi në një pjesë tjetër të të njëjtit vend, lëvizje brenda vendit, rural në urban; lëvizja e popullsisë brenda kufijve kombëtarë.
- b) Dallimin midis emigracionit dhe imigracionit. **1 pikë**
 Emigracioni është procesi i largimit të një grupi të popullsisë nga një territor i caktuar, ndërsa imigracioni është procesi i ardhjes së një grupi të popullsisë në një territor të ri.
- c) Një nga pasojat negative të lëvizjeve migratore në botë është: **1 pikë**
- mbipopullim në disa rajone, braktisje të rajoneve të tjera.
 - pabarazi rajonale.
 - probleme me integrimin e popullsisë.
 - emigracion i paligjshëm, humbje jete.
 - diskriminim nga popullsia vendase.
 - përfshirje në krimin e organizuar.
 - etj.

a) **2 pikë** Nëse nxënësi përcakton nga një tipar dallues për secilin nga llojet e lëvizjes migratore.

1 pikë Nëse nxënësi përcakton një nga tiparet dalluese të njërit prej dy nga llojet e lëvizjes migratore.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi evidenton dallimin midis emigracionit dhe imigracionit.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

c) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi identifikon një nga pasojat negative të lëvizjeve migratore në botë.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33 **4 pikë****Model përgjigje:**

a) Pasojat e ndryshimeve klimatike në aspektin natyror janë:

2 pikë

- rritja e temperaturës së tokës.
- krijimi i thatësirave.
- stuhitë e egra.
- përmbytjet.
- kafshët e egra në lëvizje.
- oqeanë më të ngruhta.
- rritja e nivelit të detit.
- ishuj dhe qytete që po humbasin.
- shkrija e akullnajave.
- etj.

b) Pasojat e ndryshimeve klimatike në sferën ekonomike janë:

2 pikë

- Bujqësi: dëmtimi i tokave bujqësore, shkretinore, probleme të sigurimit të ushqimeve.
- Industri: përdorimi dhe pakësimi i lëndëve djegëse fosile, emëtim të CO₂, CH₄.
- Shërbime: ndryshim të biodiversitetit, peisazhe të ndryshuara, dëmtim të ekosistemit.
- etj.

a) **2 pikë****2 pikë** Nëse nxënësi identifikon dy nga pasojat e ndryshimeve klimatike në aspektin natyror.**1 pikë** Nëse nxënësi identifikon një nga pasojat e ndryshimeve klimatike në aspektin natyror.**0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.b) **2 pikë****2 pikë** Nëse nxënësi identifikon dy nga pasojat e ndryshimeve klimatike në sferën ekonomike.**1 pikë** Nëse nxënësi identifikon një nga pasojat e ndryshimeve klimatike në sferën ekonomike.**0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.